

VENDIM
Nr. 1143, datë 9.12.2020

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 750, DATË
16.9.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
RREGULLORES SË POLICISË SË SHTETIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 136, të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në tekstin e rregullores së Policisë së Shtetit, të miratuar me vendimin nr. 750, datë 16.9.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

Neni 1

Në nenin 4 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 6 hiqen fjalët “ ... realizimin e detyrave nga punonjës policie në një periudhë të caktuar ...”.

2. Në pikën 16 hiqen fjalët “... ose në të gjithë territorin e vendit ...” dhe pas fjalëve “... në varësi të strukturës qendrore ...” hiqen fjalët “... apo vendore ...”.

3. Pas pikës 16 shtohet pika 16/1, me këtë përmbajtje:

“16/1. “Strukturat e veçanta” janë strukturat e policisë në varësi të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit në nivel drejtorie, sektori, komisariati, seksioni, stacioni dhe poste policie që veprojnë në një territor të caktuar ose në të gjithë territorin e vendit.”.

Neni 2

Pika 5, e nenit 6, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Në strukturat policore, në mjediset e brendshme, në muze, kabinete, klasa etj., flamuri kombëtar mund të mbahet i hapur në mure ose tenda.”.

Neni 3

Neni 8 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 8

Stema e Republikës së Shqipërisë dhe stema e Policisë së Shtetit

1. Stema e Republikës së Shqipërisë është simbol shtetëror, e cila mbahet dhe përdoret në Policinë e Shtetit, sipas modaliteteve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

2. Stema e Republikës së Shqipërisë vendoset në hyrjen kryesore të strukturave policore, mbi emërtimin e tij, në vula, si element identifikues, dhe në aktet që nxjerrin strukturat policore.

3. Stema e Policisë së Shtetit është simbol i konfiguruar i identitetit të institucionit të policisë dhe përdoret vetëm nga strukturat përbërëse të saj.

4. Stema e Policisë së Shtetit, e stilizuar në medaljone, lejohet të përdoret në uniformat e punonjësve të policisë, në kostumet sportive, në materiale kancelarie, të cilat përdoren në Policinë e Shtetit (në stilografë, stilolapsa, dosje, kalendarë, në ftesa, në njoftime, në seminare) etj.

5. Stema e Policisë së Shtetit është sipas lidhjes nr. 18 të kësaj rregulloreje.”.

Neni 4

Neni 10 shfuqizohet.

Neni 5

Në nenin 12 bëhen këto ndryshime:

1. Në fjalinë e dytë, të pikës 1, pas fjalëve “... të Policisë së Shtetit ...” hiqen fjalët “... në Akademinë e Sigurisë ...”.

2. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Në përfundim të shkollimit/formimit përkatës policor, studenti/kursanti betohet përpara flamurit kombëtar dhe flamurit të Policisë së Shtetit. Data e betimit caktohet me urdhër të drejtorit të Akademisë së Sigurisë.”.

3. Në pikën 4 hiqet fjalia “Ai mund të përcaktohet brenda institucionit të Akademisë ose jashtë tij.”.

Neni 6

Neni 17 shfuqizohet.

Neni 7

Në nenin 18 bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i nenit 18 ndryshohet dhe bëhet “Procedurat e brendshme për organizimin ose ndryshimin e strukturës”.

2. Në shkronjën “a”, të pikës 1, hiqen fjalët “... i cili, ndër të tjera, duhet të përmbajë ...” dhe nënndarjet “i”, “ii”, “iii” e “iv”.

Neni 8

Në shkronjën “c”, të pikës 5, të nenit 21, fjalët “... hartimin e strategjive njëvjeçare ...” zëvendësohen me “... dhënien e kontributeve që u kërkohen në hartimin e strategjive, programeve apo planeve të veprimit ...”.

Neni 9

Në nenin 23 bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Në pikën 2, fjalët “... drejtorit ose zëvendësdrejtorit të policisë vendore për rendin dhe sigurinë publike ...” zëvendësohen me “... drejtorit të drejtorisë vendore të policisë ...”.

2. Në pikën 3, fjalët “... shërbim policor ...” zëvendësohen me “... strukturë policore operationale ...”.

3. Në shkronjën “a”, të pikës 4, pas fjalëve “... si dhe ofrimin e shërbimeve ...” hiqet fjala “... urgjente ...” dhe pas fjalëve “... institucionet apo organizatat ...” hiqen fjalët “... sa herë që u kërkohet ...”.

4. Në shkronjën “ç”, të pikës 4, pas fjalëve “... të shkollave dhe biznesit në ...” fjala “... territorin ...” zëvendësohet me fjalën “... juridiksionin ...”.

Neni 10

Në nenin 24 bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Në pikën 1, para fjalëve "... drejtohet nga shefi i Stacionit të Policisë..." shtohen fjalët "Stacioni i Policisë ...".
2. Në shkronjën "a", të pikës 3, hiqet fjala "... urgjente ...".

Neni 11

Në pikën 2, të nenit 25, fjalët "... por në juridiksionin e tij të caktuar ..." zëvendësohen me "... brenda juridiksionit të saj ...".

Neni 12

Pikat 6, 7 e 8, të nenit 27, hiqen.

Neni 13

Neni 30 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Neni 30

Elementet e aktit administrativ dhe njohja me aktet

Procedurat e njohjes me aktet administrative dhe elementet e aktit administrativ janë në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Administrative."

Neni 14

Në nenin 33 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 4, fjala "... shifrës ..." zëvendësohet me fjalët "... Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit ...".

2. Pas pikës 4 shtohet pika 5, me këtë përmbajtje:

"5. Prodhimi, administrimi dhe qarkullimi i informacionit të klasifikuar në strukturat e policisë kryhet sipas dispozitave të akteve ligjore e nënligjore në fuqi për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror" dhe udhëzimeve të ministrit përgjegjës për çështjet e rendit dhe sigurisë publike."

Neni 15

Nenet 31, 32, 36, 40, 41, 43, 44, 45, 47, 48 dhe 49 shfuqizohen.

Neni 16

Pas pikës 8, të nenit 35, shtohet pika 9, me këtë përmbajtje:

"9. Për sigurinë e informacionit në rrjetet elektronike, nivelin e aksesit, nivelin e klasifikimit të tyre dhe mënyrën e ruajtjes së informacionit në to zbatohen aktet ligjore e nënligjore në fuqi dhe udhëzimet e ministrit përgjegjës për çështjet e rendit dhe sigurisë publike dhe të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit."

Neni 17

Në nenin 42 shtohet pika 5, me këtë përmbajtje:

“5. Të gjitha aktet, dokumentet zyrtare, regjistrimet audiovizuale, kompjuterike dhe çdo material tjetër që kategorizohet informacion i klasifikuar, klasifikohet, grumbullohet, trajtohet e administrohet sipas mënyrës së parashikuar nga legjislacioni në fuqi.”.

Neni 18

Neni 46 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 46

Hyrja dhe dalja e personave në mjediset e policisë

Rregullat dhe procedurat për hyrjen dhe daljen e personave, që nuk janë punonjës të Policisë së Shtetit, në ndërtesat/mjediset e Policisë së Shtetit, miratohen me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.”.

Neni 19

Shkronja “b”, e nenit 57, hiqet.

Neni 20

Pas pikës 9, të nenit 60, shtohet pika 9/1, me këtë përmbajtje:

“9/1. Struktura përgjegjëse për ruajtjen dhe administrimin e armatimit në Policinë e Shtetit mban një regjistër qendror për armët dhe municionet. Ky regjistër mbahet njëkohësisht në formë elektronike dhe në një libër të posaçëm.”.

Neni 21

Në nenin 61 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Miratimi i lejes pa të drejtë page për një periudhë afatshkurtër deri në 2 (dy) muaj jepet nga drejtuesi i strukturës qendrore, vendore apo të veçantë.”.

2. Pika 3 hiqet.

Neni 22

Pas nenit 61 shtohet neni 61/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 61/1

Transferimi i punonjësit të policisë në struktura të tjera shtetërore

1. Transferim në struktura të tjera shtetërore është emërimi i punonjësit të policisë në një institucion publik jashtë Policisë së Shtetit.

2. Institucioni në të cilin punonjësi i policisë transferohet është Ministria e Brendshme, institucionet në varësi të saj, si dhe organe apo institucione të tjera të administratës shtetërore, të cilat kanë në organikë funksione që mund të kryhen profesionalisht nga punonjës të Policisë së Shtetit.

3. Punonjësi i policisë mund të transferohet në funksione të ndryshme në struktura të tjera shtetërore, në rast se kjo kërkohet ose miratohet nga autoritetet zyrtare përgjegjëse, në përputhje me kriteret e parashikuara për çdo funksion.

4. Gjatë kohës që punonjësi i policisë shërben si i transferuar në pozicione të ndryshme jashtë strukturës së Policisë së Shtetit, ai nuk gëzon atributet që lidhen me statusin e policisë gjyqësore dhe as ato që lidhen me statusin e punonjësit të Policisë së Shtetit.

5. Në rastet kur punonjësi i policisë transferohet në administratën publike, ai emërohet në funksione me nivel ekuivalent me gradën e tij policore. Për procesin e ekuivalentimit të gradave të Policisë së Shtetit dhe administratës publike, për qëllime të zbatimit të këtij procesi, merren në konsideratë parashikimet në aktin nënligjor përkatës, që miraton Këshilli i Ministrave për këtë qëllim.

6. Punonjësi i policisë, i transferuar sipas këtij neni, mund të rikthehet në detyrë brenda strukturave të Policisë së Shtetit, sipas të njëjtave rregulla dhe procedura që ndiqen edhe në rastin e transferimit të tij jashtë strukturave të saj, në përputhje me kualifikimin profesional dhe gradën policore.

7. Transferimi i punonjësit të policisë në struktura të tjera shtetërore nuk konsiderohet dalje nga Policia e Shtetit në kuptim të nenit 43 të ligjit për Policinë e Shtetit.

8. Periudha e shërbimit të punonjësit të policisë së shtetit, të transferuar sipas këtij neni në funksione jashtë Policisë së Shtetit, konsiderohet si periudhë e vlefshme për efekte të vjetërsisë.

9. Punonjësi i Policisë së Shtetit ka të drejtën e lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë në pozicionet e administratës publike, sipas parashikimeve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, pas ekuivalentimit të gradave policore me ato civile.

10. Punonjësi i Policisë së Shtetit, që fiton të drejtën e studimeve në fushën e sigurisë në një prej universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose të Bashkimit Evropian, i ruhet e drejta e rikthimit në të njëjtin pozicion, me mbarimin e studimeve. Periudha e studimeve konsiderohet si periudhë e vlefshme për efekte të vjetërsisë së shërbimit.

11. Në rastet e transferimit të punonjësve të policisë në struktura të tjera zbatohen rregullat dhe procedurat e hollësishme të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave përkatës për këtë qëllim.

Neni 23

Pas pikës 2, të nenit 63, shtohen pikat 3 dhe 4, me këtë përmbajtje:

“3. Punonjëset e policisë shtatzëna dhe ato që kanë fëmijë deri në moshën 1 (një) vjeç nuk mund të urdhërohen të kryejnë shërbim natën.

4. Punonjësja e policisë nuk mban uniformë policore në muajt e dukshëm të shtatzënisë.”.

Neni 24

Nenet 64, 66, 69, 71, 72, 73, 74, 75, 76 dhe 77 shfuqizohen.

Neni 25

Në nenin 67 bëhen këto ndryshime:

1. Në shkronjën “ë”, të pikës 1, hiqet fjala “etj.” dhe pas kësaj shkronje shtohet shkronja “f”, më këtë përmbajtje:

“f) planeve të veçanta.”.

2. Pikat 2 dhe 3 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“2. Monitorimi dhe analiza për realizimin e detyrimeve të përcaktuara në strategjitë, programet dhe planet e punës në Policinë e Shtetit realizohet nëpërmjet:

- a) raporteve dhe analizës mujore;
- b) raporteve dhe analizës tremujore;
- c) raporteve dhe analizës gjashtëmujore;
- ç) raporteve dhe analizës nëntëmujore;
- d) raporteve dhe analizës vjetore (raporti vjetor i Policisë së Shtetit);

dh) raporteve dhe analizave të tjera.

3. Procedurat për hartimin, elementet përbërëse, afatet dhe strukturat përgjegjëse për hartimin e zbatimit të programeve, planeve, analizave dhe raporteve përcaktohen në urdhrin e drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.”.

Neni 26

Pas nenit 67 shtohet neni 67/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 67/1

Raporti vjetor i Policisë së Shtetit

Raporti vjetor i Policisë së Shtetit përgatitet dhe dërgohet në formë shkresore dhe elektronike në ministrinë përgjegjëse për çështjet e rendit dhe sigurisë publike brenda muajit shkurt të vitit pasardhës.”.

Neni 27

Neni 68 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 68

Përgjegjësitë për hartimin e strategjive

1. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit harton strategji sektoriale e ndërsektoriale të Policisë së Shtetit për zhvillimin e institucionit dhe për drejtime të veçanta të përgjegjësisë së saj, ndërsa drejtoria vendore e policisë harton strategji vjetore për territorin në juridiksionin e saj. Strategjitë, në bazë juridiksioni lëndor ose sipas problematikës, në Drejtorinë e Policisë së Shtetit, hartohen e ndiqen nga strukturat qendrore respektive.

2. Strategjitë e Policisë së Shtetit, përfshirë këtu edhe Strategjinë e Policimit në Komunitet hartohen në përputhje me përcaktimet e pikës 1, të këtij neni. Projektstrategjitë diskutohen paraprakisht në Këshillin e Politikave para miratimit të tyre. Projektstrategjia vjetore propozohet për miratim, brenda datës 15 dhjetor të vitit pararendës dhe miratohet brenda muajit janar të vitit zbatues të saj.”.

Neni 28

Në nenin 70 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, pas fjalës “... strategjisë ...” shtohen fjalët “... përfshirë Strategjinë e Policimit në Komunitet ...”.

2. Në shkronjën “d”, pas fjalës “... vlerësimi ...”, shtohen fjalët “... dhe zbatimi ...”.

Neni 29

Në nenin 79 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1, pas fjalëve “... punonjësve të policisë” shtohen “... agjencive të zbatimit të ligjit ...”.

2. Në pikën 4, pas fjalës “... civile ...” shtohen fjalët “... dhe agjencive të zbatimit të ligjit dhe organizmave brenda dhe jashtë vendit ...”.

3. Pas pikës 4 shtohet pika 5, me këtë përmbajtje:

“5. Parimet dhe rregullat e komunikimit të strukturave të Policisë së Shtetit me median dhe publikun përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.”.

Neni 30

Në nenin 80 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, pas fjalës “... i brendshëm ...” shtohen fjalët “... dhe i jashtëm ...”.
2. Pika 2 hiqet.
3. Në pikën 6, pas fjalës “... procedurat ...”, shtohet “... standarde ...”.

Neni 31

Në nenin 82 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Bashkëpunimi i Policisë së Shtetit me shoqërinë civile dhe komunitetin realizohet me qëllim krijimin e partneritetit dhe për t’u informuar për çështje që lidhen me rendin dhe sigurinë, si dhe për mbrojtjen e lirive dhe të të drejtave të njeriut.”.

2. Pas pikës 4 shtohen pikat 5 dhe 6, me këtë përmbajtje:

“5. Komunikimi zyrtar për çështjet teknike dhe operacionale ndërmjet Policisë së Shtetit dhe institucioneve të tjera kushtetuese brenda vendit dhe në marrëdhëniet dy- ose shumëpalëshe me jashtë, sipas marrëveshjeve të miratuara, mbahet nga drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

6. Bashkëpunimi i Policisë së Shtetit me institucionet e administratës shtetërore, agjencitë ligjzbatuese, organet e qeverisjes vendore bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara në urdhrin e drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.”.

Neni 32

Në nenin 83 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit ka të drejtë të caktojë apo të miratojë pika kontakti në strukturat policore për lehtësimin e bashkëpunimit me njësi të zbatimit të ligjit, projekte, organizata apo organizma ndërkombëtarë policorë, në përmbushje të detyrimeve të marrëveshjeve të nënshkruara.”.

2. Pas pikës 5 shtohet pika 6, me këtë përmbajtje:

“6. Mënyra e komunikimit të strukturave të policisë me partnerët ndërkombëtarë bëhet në bazë të marrëveshjeve përkatëse dhe sipas kriterëve të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për çështjet e rendit dhe sigurisë publike, për ato çështje që nuk zgjidhen nga marrëveshja respektive.”.

Neni 33

Neni 84 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 84

Policimi në komunitet

1. Policimi në komunitet është mënyrë e policimit, që synon shndërrimin e policisë në polici komunitare, pjesë integrale e komunitetit ku ajo shërben.

2. Policimi në komunitet kërkon që prioriteti kryesor i veprimtarisë së Policisë së Shtetit të jenë qytetarët dhe komuniteti.

3. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë miraton dokumentin e policimit në komunitet, në të cilin, ndër të tjera, përcaktohen:

- a) strategjitë vjetore dhe planet e veprimit;
- b) sistemi i sigurisë në komunitet dhe monitorimi i tij;
- c) bashkëpunimi me publikun;
- ç) mënyra e monitorimit;
- d) bashkëpunimi me grupet e tjera të interesit.”.

Neni 34

Në pikën 1, të nenit 86, pas fjalëve “... Strategjinë e Sigurisë Kombëtare ...” shtohen “... prioritetet vjetore të ministrisë përgjegjëse për çështjet e rendit dhe sigurisë publike ...”.

Neni 35

Në pikën 1, të nenit 89, emërtesa “... Bordin Konsultativ të Qytetarëve (BKQ) ...” zëvendësohet me fjalët “... këshillat vendorë të sigurisë publike ...” dhe pas fjalëve “... komunitetin vendor ...” shtohen “... duke përfshirë organizatat civile dhe autoritetet vendore ...”.

Neni 36

Në nenin 94 bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Në pikën 1, emërtesa “... Bordin Konsultativ të Qytetarëve (BKQ) ...” zëvendësohet me fjalët “... këshillat vendorë të sigurisë publike dhe struktura/grupe komunitare në bazë të marrëveshjeve të lidhura ndërmjet drejtorit vendor të Policisë dhe drejtuesit/drejtimesve të strukturës/grupit komunitar ...”.

2. Pika 2 hiqet.

3. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Raportet e vlerësimit dhe rekomandimet nga këshillat vendorë të sigurisë publike dhe strukturat/grupet komunitare, të cilat i paraqiten Drejtorisë së Policisë të Shtetit bëhen publike nga Policia e Shtetit me mjete zyrtare të komunikimit.”.

Neni 37

Pas nenit 96 shtohet neni 96/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 96/1

Vlerësimi i performancës së Policisë së Shtetit

Policia e Shtetit, në vlerësimin e performancës, e cila kryhet nga struktura përgjegjëse, mban në konsideratë, në kriteret e procesit të vlerësimit, edhe konkluzionet, vlerësimet apo rekomandimet e dhëna nga faktorë të jashtëm, siç janë strukturat e specializuara në ministrinë përgjegjëse për çështjet e rendit dhe të sigurisë publike, si dhe organizata partnere, kombëtare apo ndërkombëtare, me reputacion në fushën e rendit dhe sigurisë publike.”.

Neni 38

Në pikën 1, të nenit 99, emërtesa “... Drejtoria e Standardeve Profesionale ...” zëvendësohet me fjalët “... drejtuesi/titullari i strukturës përgjegjëse për vlerësimin e standardeve profesionale ...”.

Neni 39

Në pikat 2 dhe 3, të nenit 100, fjalët "... Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit ..." zëvendësohen me "... drejtuesit/titullarit të strukturës përgjegjëse për vlerësimin e performancës ...".

Neni 40

Në nenin 102 bëhen këto ndryshime:

1. Në paragrafin e parë, fjalët "... çdo rekomandim të Drejtorisë së Standardeve Profesionale ..." zëvendësohen me "... rekomandimet e raporteve të vlerësimit ...".
2. Në fjalinë e dytë, emërtesa "... Drejtoria e Standardeve Profesionale ..." zëvendësohet me fjalët "... struktura përgjegjëse për vlerësimin e standardeve profesionale në Policinë e Shtetit dhe ministrinë përgjegjëse për çështjet e rendit dhe sigurisë publike ...".

Neni 41

Nenet 103, 106, 107, 108, 109, 111, 122, 123 dhe 124 shfuqizohen.

Neni 42

Në nenin 114 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 3, fjalët "... kur ato përbëjnë "sekret shtetëror" ose kanë karakter personal" hiqen.
2. Pas pikës 3 shtohet pika 4, me këtë përmbajtje:
"4. Punonjësi i Policisë së Shtetit, gjatë periudhës së ushtrimit të funksionit të tij, duhet:
a) të sigurojë mbrojtjen dhe mospërhapjen e paautorizuar, të personat e tretë, të informacionit për të cilin ka marrë dijeni për shkak të detyrës, detyrim ky që vazhdon edhe pasi ai ndërpret marrëdhëniet e punës;
b) të mos e përdorë informacionin e mbledhur për shkak të detyrës për qëllime të tjera, jashtë atyre të përcaktuara me ligj;
c) të sigurojë mbrojtjen dhe mospërhapjen e të dhënave personale të personave, të mbrojtura sipas ligjit, me të cilat njihet gjatë ushtrimit të detyrës."

Neni 43

Në pikën 3, të nenit 116, pas fjalës "... veprimtarinë ..." shtohet lidhëza "e" dhe hiqen fjalët "... sekrete të punës së ...".

Neni 44

Në nenin 127 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:
"1/1. Bazuar në nevojat e identifikuara të Policisë së Shtetit, shpallen kuotat e aplikimit për pranim në Akademinë e Sigurisë edhe për shtetas që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 2, të nenit 38, të ligjit për Policinë e Shtetit dhe kriteret e veçanta në bazë të nevojave të Policisë së Shtetit, të përcaktuara me urdhër të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike."
- Pas pikës 3 shtohet pika 4, me këtë përmbajtje:
"4. Vetëm personat që kanë mbushur moshën 19 vjeç dhe janë nën 30 vjeç kanë të drejtë të aplikojnë për t'u pranuar në kurset e Akademisë së Sigurisë për t'u rekrutuar në Policinë e Shtetit."

Neni 45

Në nenin 128 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Kuotat e pranimi përcaktohen nga drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, sipas nevojave për personel që kanë strukturat e Policisë së Shtetit, bazuar në limitin e përcaktuar organik dhe tavaneve buxhetore të miratuara të periudhës.”.

2. Në pikën 2, pas fjalëve “... më pak të përfaqësuar ...” shtohen “... fëmijët e punonjësve të policisë të rënë në krye të detyrës ...”.

Neni 46

“Neni 130

Neni 130, ndryshohet, si më poshtë:

1. Shtetasi paraqet në drejtorinë vendore të policisë kërkesën e motivuar, ku shpreh arsyet për t’u pranuar në Policinë e Shtetit.

2. Dokumentet për aplikim janë, si më poshtë vijon:

a) formulari i aplikimit dhe autorizimi për sigurimin e dokumentacionit;

b) fotokopje e kartës së identitetit;

c) dokument zyrtar që vërteton përfundimin e arsimit;

ç) fotokopje e dëshmisë së aftësisë së drejtimit të automjetit të tipit “B”;

d) certifikatë e gjendjes gjyqësore;

dh) certifikatë familjare;

e) vërtetim nga gjykata;

ë) vërtetim nga prokuroria;

f) raport mjekoligjor;

g) fotokopje të librezës së punës ose vërtetim që ndjek arsimin e lartë (nëse i disponon);

gj) dokument të lëshuar nga institucionet shëndetësore që vërteton se nuk është përdorues i lëndëve narkotike.

3. Dokumentet e përcaktuara në shkronjat “b”, “ç”, “d”, “dh”, “e”, “ë”, të pikës 2, të këtij neni, sigurohen nga struktura përgjegjëse për burimet njerëzore në Policinë e Shtetit përmes komunikimit zyrtar me strukturat/agjencitë/institucionet përgjegjëse për lëshimin e tyre, aksesit në bazat e të dhënave të përbashkëta me këto struktura/agjenci/institucione ose sistemeve të qarkullimit ndërinstitucional të dokumenteve me nënshkrim elektronik.

4. Shtetasi që aplikon për pranimin në Akademinë e Sigurisë, i cili ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë, paraqet në drejtorinë vendore të policisë, përveç dokumentacionit të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, diplomën dhe listën e notave të ciklit të parë dhe të dytë të arsimit të lartë.”.

Neni 47

Në pikën 1, të nenit 134, fjalët “... *website*-in e Policisë së Shtetit ...” ndryshohen me “... faqen zyrtare të Policisë së Shtetit, Akademisë së Sigurisë ...”.

Neni 48

Pas nenit 135 shtohet neni 135/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 135/1

Shpallja e thirrjes për konkurrim të fëmijëve të punonjësve të policisë, që kanë humbur jetën për shkak të detyrës

1. Për aplikantët që hyjnë në kategorinë e fëmijëve të punonjësve të policisë që kanë humbur jetën për shkak të detyrës përcaktohen procedura lehtësuese për pranimin e tyre në Akademinë e Sigurisë.

2. Kriteret dhe procedura e testimit të kësaj kategorie përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për çështjet e rendit dhe sigurisë publike.”.

Neni 49

Në nenin 136 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshon, si më poshtë vijon:

“1. Struktura përgjegjëse në Drejtorinë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për koordinimin dhe monitorimin e procesit të pranimin në Akademinë e Sigurisë është struktura përgjegjëse për burimet njerëzore.”.

2. Në shkronjën “b”, të pikës 3, fjala “... drejtoria ...” ndryshohet me “... struktura ...”.

Neni 50

Në nenin 140 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas shkronjës “ë”, të pikës 1, shtohen shkronjat “f” dhe “g”, me këtë përmbajtje:

“f) nuk kalon kontrollin shëndetësor ose gjatë këtij kontrolli evidentohen tatuazhe në pjesët e dukshme të trupit;”

g) nuk gëzon besueshmëri për të qenë në radhët e Policisë së Shtetit”;

2. Shkronja “dh” ndryshon me këtë përmbajtje:

“dh) pas procesit të verifikimit përfundimtar rezulton se ai është dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo të një kundërvajtjeje penale me dashje”.

3. Në pikën 2, pas fjalës “... konkurrimit” shtohen fjalët “... dhe kontrollit ...”.

Neni 51

Neni 142 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 142

Publikimi i rezultateve të kandidatëve

1. Në përfundim të procesit të konkurrimit, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit publikon në *website*-in e Policisë, listën e rezultateve përfundimtare sipas rendit zbritës.

2. Pas çdo faze konkurrimi dhe kontrolli, Akademia e Sigurisë publikon në faqen zyrtare të saj listën e rezultateve sipas rendit zbritës.

3. Në përfundim të procesit të konkurrimit, struktura përgjegjëse për burimet njerëzore publikon në faqen zyrtare të Policisë së Shtetit, listën e rezultateve përfundimtare sipas rendit zbritës”.

Neni 52

Në nenin 143 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, pas fjalës “... konkurrimi” shtohet “... dhe kontrollit”.

2. Në pikën 2, emërtesa “Drejtoria e Burimeve Njerëzore” zëvendësohet me emërtesën “Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit”.

3. Në pikën 4, fjalët “... shkollimi bazë ...” ndryshohen me “... shkollimin bazë dhe studimet/kualifikimet ...”.

Neni 53

Neni 145 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 145 **Pranimi në polici**

Me përfundimin e shkollimit bazë dhe studimeve/kualifikimeve, studenti/kursanti pranohet si punonjës policie, i jepet grada policore përkatëse “inspektor” ose “nënkomisar” dhe emërohet në detyrë me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.”.

Neni 54

Në nenin 148 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshon, si më poshtë vijon:

“1. Punonjësi i Policisë, pas pranimi në Policinë e Shtetit, i nënshtrohet periudhës njëvjeçare të provës, periudhë e cila fillon në datën kur punonjësi i policisë emërohet në detyrë me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.”.

2. Në pikën 3 fjalët “Drejtori i Policisë së Shtetit, në bazë të propozimit të strukturave të policisë vendore” ndryshohen me “titullari i strukturës në bazë të propozimit të eprorit të drejtpërdrejtë”.

3. Pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Akti administrativ për shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 3, nxirret nga drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.”.

Neni 55

Pas nenit 149 shtohet neni 149/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 149/1 **Kriteret e pranimi për nevoja të veçanta**

Për plotësimin e nevojave të veçanta pranohen në Policinë e Shtetit ushtarakë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara në ligjin për Policinë e Shtetit.”.

Neni 56

Në nenin 150, pas paragrafit të parë shtohet paragrafi i dytë, me këtë përmbajtje:

“Funksionet e veçanta në strukturën organike të Policisë së Shtetit përcaktohen me propozim të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë dhe miratim të ministrit përgjegjës për çështjet e rendit dhe sigurisë.”.

Neni 57

Pika 5, e nenit 156, ndryshohet me këtë përmbajtje:

“5. Strukturat përgjegjëse për menaxhimin e trajnimeve funksionale-profesionale janë departamentet, strukturat e veçanta, strukturat vendore, sipas shërbimeve përkatëse në Policinë e Shtetit dhe Akademia e Sigurisë”.

Neni 58

Në nenin 157 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Të gjithë punonjësit e policisë, pavarësisht nga grada dhe funksioni që mbajnë, çdo vit i nënshtrohen testimit fizik dhe profesional sipas normave dhe kritereve të përcaktuara në rregulloren e testimit fizik.”.

Pas pikës 1 shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

“1/1. Testimi fizik i punonjësve të policisë zhvillohet në strukturat, ku ata janë efektivë. Rezultatet e testimit fizik janë pjesë e vlerësimit të përgjithshëm për përparimin e tyre në gradë dhe në karrierë. Normat dhe rregullorja e testimit fizik miratohen nga drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, në përputhje me përcaktimet e ligjit për Policinë e Shtetit.”.

Neni 59

Në nenet 158, 159 dhe 160, emërtesa “Drejtorja e Burimeve Njerëzore në Policinë e Shtetit” ndryshohet me fjalët “struktura përgjegjëse për burimet njerëzore dhe struktura përgjegjëse për trajnimet.”.

Neni 60

Në nenin 161 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1 në fund të fjalisë shtohet togfjalëshi “... si më poshtë:” dhe shkronjat “a”, “b”, “c” me këtë përmbajtje:

a) të ketë vlerësim të aftësive individuale të punës (të performancës) jo më ulët se 70% të pikëve të vlerësimit të përgjithshëm, gjatë kohës së qëndrimit në gradë;

b) të ketë përfunduar arsimin dhe kualifikimin përkatës për gradën për të cilën konkurron sipas përcaktimeve të nenit 161/3 të kësaj rregulloreje;

c) të plotësojë kohën e qëndrimit në gradë sipas të afateve të përcaktuara në shkronjën “ë”, të pikës 1, të nenit 55, të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar dhe nenit 161/2, të kësaj rregulloreje.”.

2. Pikat 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7 shfuqizohen.

Neni 61

Pas nenit 161 shtohen nenet 161/1 deri në 161/7, me këtë përmbajtje:

“Neni 161/1

Kriteret për aplikim për gradimin e radhës

1. Punonjësi i policisë ka të drejtë të aplikojë për fitimin e gradës policore të radhës, kur plotëson kriteret e mëposhtme:

a) të ketë vlerësim të aftësive individuale të punës (të performancës) jo më ulët se 70% të pikëve të vlerësimit të përgjithshëm, gjatë kohës së qëndrimit në gradë;

b) të jetë parashkruar masa disiplinore për shkelje të rëndë, sipas afatit të përcaktuar në ligjin “Për Policinë e Shtetit”;

c) të mos ketë filluar ndaj tij procedimi penal;

ç) të mos ketë filluar ndaj tij procedimi disiplinor për shkelje të rëndë;

d) të ketë plotësuar kohën e qëndrimit në gradë sipas afateve të përcaktuara në ligjin nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar.

2. Konkurrimi për fitimin e gradës bëhet vetëm për gradën pasardhëse.

Neni 161/2
Afatet e qëndrimit në gradë

1. Punonjësi i Policisë, për të aplikuar për gradën e radhës, duhet të plotësojë afatet e mëposhtme:

- a) nga “Inspektor” deri në “Inspektor i dytë”: 5 vjet;
- b) nga “Inspektor i dytë” në “Inspektor i parë”: 10 vjet;
- b/1) Punonjësit të policisë në rolin zbatues, që ka vjetërsi shërbimi mbi 5 vjet, i lind e drejta për të konkurruar për fitimin e gradës “Nënkomisar”;
- c) nga “Nënkomisar” në “Komisar”: 3 vjet;
- ç) nga “Komisar” në “Kryekomisar”: 3 vjet;
- d) nga “Kryekomisar” në “Drejtues”: 5 vjet;
- dh) nga “Drejtues” në “Drejtues i parë”: 3 vjet.

2. Në vjetërsinë për efekt gradimi nuk llogaritet koha e ndërprerjes së karrierës, për shkak të lejes së përfituar pa të drejtë page.

3. Në vjetërsinë për efekt konkurrimi për fitimin e gradës llogaritet edhe koha e ndërprerjes së karrierës, për shkak të:

- a) paafëtisë së shëndetësore deri në 6 muaj, brenda afatit 12-mujor;
- b) vjetërsisë së shërbimit të njohur me vendim gjyqësor;
- c) lejes së lindjes.

Neni 161/3
Arsimimi dhe kualifikimet për fitimin e gradës

Kurset e detyrueshme për fitimin e gradës janë:

- a) për gradën “Inspektor i dytë”, të ketë përfunduar kursin e trajnimit për Inspektor i dytë;
- b) për gradën “Inspektor i parë”, të ketë përfunduar kursin e trajnimit për Inspektor i parë;
- c) për gradën “Komisar” të ketë përfunduar kursin e trajnimit për Komisar;
- ç) për gradën “Kryekomisar” të ketë përfunduar kursin e trajnimit për Kryekomisar;
- d) për gradën “Drejtues” të ketë përfunduar masterin profesional në fushën e rendit dhe të sigurisë publike;
- dh) për gradën “Drejtues i parë” të ketë përfunduar kursin për “Drejtues të parë”.

Neni 161/4
Procedura e aplikimit dhe verifikimit

1. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, në varësi të nevojave të Policisë së Shtetit, nxjerr urdhrin për kuotat për gradimet e radhës dhe afatet e këtij procesi në Policinë e Shtetit.

2. Fillimi i procesit të gradimeve shpallet në faqen zyrtare të Policisë së Shtetit, si dhe dërgohet zyrtarisht në të gjitha strukturat e saj për mundësimin e konkurrimit të personelit të interesuar jo më vonë se 30 ditë nga data e konkurrimit. Për këtë qëllim, mund të përdoren edhe format e tjera të komunikimit publik.

3. Procesi i gradimeve zhvillohet vetëm një herë në vit për një gradë të caktuar policore.

4. Punonjësi që dëshiron të marrë pjesë në procesin e konkurrimit për fitimin e gradës, aplikon pranë strukturës ku është i emëruar, brenda afatit të përcaktuar.

5. Struktura vendore bën verifikimin e dokumentacionit për plotësimin e kriterëve të çdo aplikanti. Për aplikantët që plotësojnë kriteret për konkurrim për fitim grade hartohet dhe dërgohet lista emërore me dokumentacionin përkatës të aplikimit në strukturën përgjegjëse për burimet njerëzore. Për ata që nuk plotësojnë këto kriterë kthehet përgjigje për arsyet e mospranimin të aplikimit.

6. Struktura përgjegjëse për burimet njerëzore dhe struktura përgjegjëse për trajnimet, pas riverifikimit të dokumentacionit të aplikantëve, hartojnë listën emërore përfundimtare të aplikantëve, që plotësojnë kriteret për konkurrim për fitim grade, duke i caktuar secilit aplikant një numër kodik identifikimi dhe ia dërgojnë atë strukturës përgjegjëse për menaxhimin e procesit të gradimeve.

7. Aplikanti që, pas riverifikimit, nuk plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 161, të kësaj rregulloreje, skualifikohet. Ai njoftohet zyrtarisht për arsyet e mospranimit të aplikimit për konkurrim.

8. Aplikanti i skualifikuar ka të drejtën e ankimit, sipas përcaktimeve në nenin 161/7, të kësaj rregulloreje.

Neni 161/5

Zhvillimi i procedurës së konkurrimin për fitimin e gradës

1. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit përcakton me urdhër fillimin e procesit të konkurrimin për fitimin e gradës së radhës, fazat e konkurrimin, si dhe afatet për zhvillimin e tyre.

2. Procedura e konkurrimin dhe kriteret e vlerësimit për fitimin e gradës së radhës, duke filluar nga aplikimi deri në vlerësimin përfundimtar të aplikantëve, zhvillohen sipas standardeve të përcaktuara me udhëzim të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.

Neni 161/6

Shkollimi/trajnimi i aplikantëve fitues dhe dhënia e gradës

1. Konkurrentët e shpallur fitues në fazat e testimit/vlerësimit i nënshtrohen arsimimit/trajnimin për gradën përkatëse në Akademinë e Sigurisë.

2. Numri i punonjësve të policisë që do të ndjekin programin e shkollimit/trajnimin nuk mund të jetë më shumë se 30% mbi numrin e vendeve të lira të shpallura për gradën përkatëse.

3. Pas përfundimit të programit të arsimimit/trajnimin, renditja e konkurrentëve bëhet sipas shumës së pikëve të arritura gjatë testimit/vlerësimit dhe arsimimit/kualifikimit për gradën përkatëse, duke filluar nga punonjësi, i cili ka vlerësimin më të lartë, duke bërë listim të ndarë ndërmjet fituesve dhe listës së pritjes.

4. Afati i qëndrimit në listë pritjeje për dhënien e gradës nuk mund të jetë më shumë se 12 (dymbëdhjetë) muaj.

Nëse brenda këtij afati nuk bëhet e mundur dhënia e gradës, punonjësi i nënshtrohet konkurrimin të radhës.

5. Bazuar në aktin përfundimtar të vlerësimit, komisioni përkatës i gradimit i paraqet drejtorit të Përgjithshëm të Policisë listën emërore të aplikantëve fitues, sipas rendit zbritës dhe listën e pritjes.

Neni 161/7

Procesi i ankimit

1. Punonjësi i policisë ka të drejtën e ankimit për çdo fazë të procesit për fitimin e gradës.

2. Ankimi bëhet me shkrim dhe i dërgohet komisionit të apelimit për fitimin e gradës, brenda 7 ditëve pune nga momenti i skualifikimit ose i shpalljes së rezultateve të testimit.

3. Komisioni i apelimit për fitimin e gradës ngrihet me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë në të njëjtën kohë me ngritjen e komisioneve të gradimit.

4. Komisioni i apelimit shqyrton ankesat dhe merr vendim brenda 30 ditëve pune, nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

5. Ankuesit i kthehet përgjigje zyrtare me shkrim brenda 7 ditëve pune nga data e marrjes së vendimit nga komisioni.

6. Formularët e vlerësimit, fletët e testimit të plotësuara në mënyrë fizike ose elektronike nuk i jepen aplikantit dhe nuk bëhen publike.

7. Ushtrimi i së drejtës së ankimit, brenda afatit të përcaktuar në këtë rregullore, pezullon nxjerrjen e urdhrit të drejtorit të Policisë së Shtetit dhe efektet e aktit të vlerësimit të komisionit të gradimit që është ankimuar.

8. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës së aplikantit, nëse komisioni e vlerëson të drejtë, ai njoftohet jo më vonë se dy ditë para datës së fillimit të fazës pasardhëse të testimit.

9. Vendimi i komisionit të apelimit për fitimin e gradës është i zbatueshëm menjëherë.

10. Gjatë procesit të ankimit, punonjësit të policisë i garantohet e drejta për t'u informuar, dëgjuar dhe mbrojtur, në përputhje me parimet e Kodit të Procedurave Administrative.

11. Urdhri i drejtorit të Përgjithshëm të Policisë për dhënien e gradave miratohet pas përfundimit të afateve të procesit të apelimit.”.

Neni 62

Në nenin 162 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Grada “Nënkomisar” fitohet pas shpalljes fitues në procesin e konkurrimit dhe përfundimit të ciklit të parë të studimeve të arsimit të lartë ose pas përfundimit të kursit përkatës në Akademinë e Sigurisë për konkurrentët që kanë përfunduar ciklin e dytë të arsimit të lartë.”.

2. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Gradat “Inspektor i dytë”, “Inspektor i parë”, “Komisar”, “Kryekomisar”, “Drejtues” dhe “Drejtues i parë” fitohen nëpërmjet konkurrimit për gradim.”.

4. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Gradat “Drejtues i lartë” dhe “Drejtues madhor” jepet në momentin e emërimit të punonjësit që i korrespondojnë këto grada.”.

5. Pikat 5 dhe 6 hiqen.

Neni 63

Nenet 163, 164 165, 166, 167, 168, 169, 170, 171 dhe 172 shfuqizohen.

Neni 64

Në pikën 1, të nenit 173, emërtesa “... Drejtoria e Standardeve Profesionale ...” ndryshohet me fjalët “... struktura përgjegjëse për vlerësimin e standardeve profesionale ...”

Neni 65

Në pikën 7, të nenit 177, fjala “tip” hiqet.

Neni 66

Në titullin e kreut VII, përpara fjalës “transferimi ...” shtohet “emërimi ...”.

Neni 67

Pas nenit 179 shtohen nenet 179/1, 179/2, 179/3, 179/4, 179/5, 179/6 dhe 179/7 me këtë përmbajtje:

“Neni 179/1

Këshilli i vlerësimit të propozimeve për emërim

1. Emërimi në detyrë i punonjësve të policisë bëhet në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara në këtë rregullore dhe me miratim të autoriteteve që përcakton ligji për Policinë e Shtetit.

2. Këshilli i vlerësimit të propozimeve për emërim shqyrton dhe i propozon autoritetit që ka në kompetencë emërimin e punonjësve të policisë, emërimin e kandidatëve, që:

- a) përfundojnë studimet në Akademinë e Sigurisë;
- b) përfundojnë kurset e specializimit dhe të kualifikimit në institucionet e lartpërmendura dhe/ose ato homologe jashtë vendit;
- c) kanë fituar gradën e radhës dhe janë objekt i lëvizjes në detyrë;
- ç) propozohen nga eprorët për t'u ngritur ose ulur në detyrë;
- d) paraqesin vetë kërkesë për të lëvizur nga detyra;
- dh) transferimi i tyre është i detyrueshëm;
- e) janë ulur në detyrë si rezultat i masës disiplinore të dhënë ose i vlerësimit individual;
- ë) rikthehen në strukturat e policisë.

Neni 179/2

Kriteret e emërimit në detyrë të punonjësve të policisë

Emërimi në detyrë i punonjësve të policisë bëhet në bazë të kriterëve, si më poshtë vijon:

- a) performanca në punë;
- b) formimi dhe kualifikimi;
- c) vjetërsia në shërbim;
- ç) vjetërsia në gradë.

Neni 179/3

Organizimi i Këshillit të Vlerësimit të Propozimeve për Emërim

Këshilli i vlerësimit të propozimeve për emërim është i përhershëm dhe funksionon në dy nivele, atë qendror dhe vendor. Në nivel qendror funksionon përmes Këshillit të Lartë të Vlerësimit të Propozimeve për Emërim dhe në nivel vendor përmes Këshillit Vendor të Vlerësimit të Propozimeve për Emërim.

Neni 179/4

Përbërja dhe funksionimi i Këshillit të Lartë të Vlerësimit të Propozimeve për Emërim

1. Këshilli i Lartë i Vlerësimit të Propozimeve për Emërim përbëhet nga:
 - a) zëvendësudrejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit;
 - b) drejtori i Departamentit të Varësisë Lëndore;
 - c) drejtori i strukturës përgjegjëse për burimet njerëzore;
 - ç) rektori i Akademisë së Sigurisë;
 - d) drejtori Juridik i Policisë së Shtetit.
2. Këshilli i Lartë i Vlerësimit të Propozimeve për Emërim ka të drejtë t'i propozojë drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për emërimin në detyrë të punonjësit të policisë me gradë "Komisar" deri "Drejtuës i Parë".

Neni 179/5

Përbërja dhe funksionimi i Këshillit Vendor të Vlerësimit të Propozimeve për Emërim

1. Këshilli Vendor i Vlerësimit të Propozimeve për Emërim përbëhet nga:

a) zëvendës drejtori i Policisë së Qarkut/zëvendëskomandanti i repartit/zëvendësshefi i institucionit;

b) shefi i sektorit ku punonjësi ka varësinë sektoriale;

c) shefi i sektorit ku punonjësi kalon në varësi të tij;

ç) shefi i sektorit/seksionit përgjegjës për burimet njerëzore;

d) juristi i drejtorisë vendore.

2. Kur punonjësi lëviz dhe emërohet në detyrë brenda të njëjtë sektor, merr pjesë vetëm shefi që e ka në varësi sektoriale.

3. Këshilli Vendor i Vlerësimit të Propozimeve për Emërim ka të drejtë t'i propozojë titullarit të strukturës vendore/autonome për emërim në detyrë të punonjësit të policisë me gradë "Inspektor" deri në "Nënkomisar".

Neni 179/6

Vendimmarrja në Këshillin e Vlerësimit të Propozimeve për Emërim

1. Vendimet në Këshillin e Vlerësimit të Propozimeve për Emërim merren me shumicë të thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm, ku duhet të jenë të pranishëm më shumë se gjysma e tyre.

2. Kur votat ndahen në mënyrë të barabartë, propozohet kandidati për të cilin ka votuar kryesuesi i Këshillit të Vlerësimit të Propozimeve për Emërim.

3. Nuk mund të marrin pjesë në Këshillin e Vlerësimit të Propozimeve për Emërim punonjësit e policisë që diskutohen vetë për t'u emëruar në detyrë.

4. Këshilli i Vlerësimit të Propozimeve për emërim, si rregull, mbledhet sa herë që krijohen vende organike të lira dhe në çdo kohë për raste të jashtëzakonshme.

5. Dokumentet përkatëse, si dosje personale, vlerësimet e punës, propozimet e bëra, vendimet e komisioneve të gradimit e të dhëna të tjera, Këshillit të Vlerësimit të Propozimeve për Emërim i paraqiten nga drejtorja/sektori përkatës përgjegjës për burimet njerëzore, e/i cila/cili ruan edhe procesverbalet e takimeve dhe të vendimmarrjes së Këshillit të Vlerësimit të Propozimeve për Emërim.

6. Këshilli i Vlerësimit të Propozimeve për Emërim shqyrton dhe i propozon autoritetit që ka në kompetencë emërimin e punonjësve të policisë, të paktën, dy kandidatura, sa herë kjo është e mundur dhe, nëse janë më shumë se dy kandidatura apo alternativa, i propozon ato në bazë të një renditjeje.

Neni 179/7

Akti i emërimit në detyrë

1. Akti që përpilon Këshilli i Vlerësimit të Propozimeve për Emërim emërtohet "Propozim".

2. Akti që përpilon struktura përgjegjëse për burimet njerëzore dhe që miratohet nga titullari i organit/repartit emërtohet "urdhër".

3. Struktura që bën emërimin në detyrë të punonjësit në aktin e emërimit përshkruan bazën ligjore, propozimin e Këshillit të Vlerësimit të Propozimeve për Emërim në rastin e emërimeve, gradën, emër, atësi, mbiemër, funksionin (detyrën) që kryen ose që do të kryejë punonjësi, motivacionin, pagën, datën e ndryshimit të marrëdhënieve financiare, datën e hyrjes në fuqi të urdhrit, si dhe nënshkrimin e titullarit.

4. Akti i emërimit në detyrë i komunikohet punonjësit nga struktura përgjegjëse për burimet njerëzore, jo më vonë se 48 orë nga koha e protokollimit në sekretari.

5. Punonjësi i policisë me marrjen e njoftimit bën dorëzimin e detyrës, në përputhje me dispozitat ligjore.

Neni 68

Pika 3, e nenit 186 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Stimujt mund të jepen edhe për punonjës të agjencive të zbatimit të ligjit të vendeve partnere, organizmave apo organizatave ndërkombëtare, kur ata japin kontribut të rëndësishëm në bashkëpunim me Policinë e Shtetit.”.

Neni 69

Pas pikës 3, të nenit 189, shtohet pika 4, me këtë përmbajtje:

“4. Për stimujt që jepen për punonjës të agjencive të zbatimit të ligjit të vendeve partnere, organizmave apo organizatave ndërkombëtare, propozimi bëhet nga drejtuesit e strukturave të Policisë së Shtetit që kanë përfituar nga bashkëpunimi.”.

Neni 70

Pas pikës 4.1, të nenit 193, shtohet pika 4.1.1, me këtë përmbajtje:

“4.1.1 Strukturat përkatëse në Policinë e Shtetit depozitojnë në dosjen e personelit të punonjësve të policisë edhe certifikatën e sigurisë së personelit ose kopje të njësuar me origjinalin, për funksionet organike, që, për shkak të detyrës, njihen me informacionin e klasifikuar.”.

Neni 71

Në pikën 3, të nenit 194, pas nënndarjes “Regjistri i punonjësve civilë në Policinë e Shtetit”, shtohen nënndarjet, me këtë përmbajtje:

- Regjistri i lejeve për punësimin në veprimtari të dyta;
- Regjistri i evidentimit të stimujve dhe shpërblimeve;
- Regjistri i evidentimit të punonjësve të policisë, subjekt të vlerësimit kalimtar.”.

Neni 72

Në nenin 198 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Sillet dhe komunikon në mënyrë joetike, si gjatë kryerjes së detyrës, ashtu edhe jashtë saj.”.

2. Pika 2 hiqet.

3. Pas pikës 5 shtohet pika 5/1, me këtë përmbajtje:

“5/1. Gjatë detyrës/shërbimit përdor telefonin dhe rrjetet sociale për arsye që nuk lidhen me objektin e punës.”.

4. Pas pikës 12 shtohet pika 13, me këtë përmbajtje:

“13. Ndikon te perceptimi i publikut kur paraqet në rrjetet sociale, pa miratim, materiale të Policisë së Shtetit, të tilla si: dokumente, fotografi, regjistrime audio, video apo në çdolloj forme tjetër, të cilat i disponon/akseson, për shkak të detyrës ose materiale me përmbajtje denigruese, diskredituese, diskriminuese, fyese, politike ose fetare.”.

Neni 73

Pas pikës 2 të nenit 199, shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1. Nuk informon në kohë eprorin në lidhje me detyrën e dhënë dhe problematikat e ndodhura gjatë dinamikës në punë.”.

Neni 74

Pas pikës 10 të nenit 200, shtohet pika 11, me këtë përmbajtje:

“11. Nga pakujdesia, nuk përmbush apo nuk zbaton detyrat në përputhje me parimet, procedurat dhe rregullat mbi bazën e të cilave funksionon Policia e Shtetit, por që nuk kanë cenuar kryerjen e detyrave dhe nuk kanë sjellë pasoja të rënda.”.

Neni 75

Pika 28, e nenit 205, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“28. Sillet dhe komunikon në mënyrë jo etike, duke përdorur fjalë apo shprehje të rënda fyese, përbuzëse apo kërcënuese, si gjatë kryerjes së detyrës edhe jashtë saj, ndaj kolegëve apo ndaj qytetarëve.”.

Neni 76

Neni 213 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 213

Punonjësi është përgjegjës për përdorim të lëndëve narkotike, nëse:

1. Mban lëndë narkotike në mënyrë të jashtëligjshme;
2. Përdor lëndë narkotike;
3. Refuzon t'i nënshtrohet testit të përdorimit të lëndëve narkotike;
4. Nuk informon në kohë për kultivimin e lëndëve narkotike.”.

Neni 77

Neni 215 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 215

Veprimet diskriminuese

Punonjësi i policisë është përgjegjës për veprimet diskriminuese në bazë të moshës, gjinisë, racës, kombësisë, gjuhës, orientimit seksual, aftësisë së kufizuar fizike apo mendore, bindjes politike, përkatësisë etnike dhe fetare, ose sociale.”.

Neni 78

Në nenin 240 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Zëvendësudrejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit ka të drejtë të japë masën disiplinore:

a) “Shtyrje e afatit të gradimit deri në 2 vjet”, për drejtorët e departamenteve, drejtorët qendrorë dhe drejtorët vendorë të policisë, shefat e komisariateve në drejtoritë vendore të policisë.

b) Procedura e ankimit kundër këtij vendimi bëhet sipas përcaktimeve të bëra në nenin 95, të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar.”.

2. Në shkronjën “a”, të pikës 2, fjalët “Ulje me një gradë për një periudhë deri në 6 muaj” hiqen.

3. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Drejtuesit e departamenteve, drejtuesit e drejtorive qendrore në drejtoritë e përgjithshme të policisë së shtetit, në varësi të drejtpërdrejtë të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, drejtuesi i Akademisë së Sigurisë kanë të drejtë të propozojnë masat disiplinore “vërejtje” dhe “vërejtje me paralajmërim” tek eprori që ka të drejtën e dhënies së masës disiplinore për punonjësit e policisë dhe punonjësit administrativë që kanë në varësi administrative dhe lëndore.”.

4. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Drejtuesit e drejtorive vendore, drejtorive të kufirit dhe migracionit, shefat e komisariateve të policisë, titullarët e strukturave të forcave speciale e ndërhyrjes së shpejtë dhe strukturave të veçanta kanë të drejtë të japin masat disiplinore “vërejtje” dhe “vërejtje me paralajmërim” për punonjësit e policisë dhe punonjësit administrativë që kanë në varësi administrative dhe lëndore.”.

Neni 79

Në nenin 241 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 2, në fund të fjalisë shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Raporti përfundimtar i strukturës përgjegjëse për vlerësimin e performancës, për dhënien e masës disiplinore, dërgohet për zbatim në strukturat e përcaktuara në pikat 3 dhe 4, të nenit 240.”.

2. Në pikën 3, të këtij neni, në fund të fjalisë shtohen fjalët “... për përfundimin e hetimit disiplinor”.

Neni 80

Pas pikës 1, të nenit 242, shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

“1/1. Kur punonjësi i policisë është me raport mjekësor, me pushime jashtë shtetit ose me pushime vjetore, komunikimi bëhet brenda 3 (tri) ditëve pune nga dita e paraqitjes në detyrë të punonjësit. Për oficerët e kontaktit dhe ata të dërguar me shërbim jashtë shtetit, komunikimi bëhet në rrugë elektronike (*email*).”.

Neni 81

Në nenin 246 bëhen këto shtesa:

1. Pas pikës 3 shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

“3/1. Në rastet kur zëvendës drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit jep vetë masë disiplinore, Komisioni Qendror i Apelit shqyrton ankesën pa prezencën e tij dhe e relaton pranë drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për vendim.

Në këtë rast, Komisioni Qendror i Apelit drejtohet nga anëtari me gradë më të lartë e vjetërsi shërbimi më të gjatë.”.

2. Pas pikës 6 shtohet pika 6/1, me këtë përmbajtje:

“6/1. Komisioni i Apelit, në përfundim të shqyrtimit të ankesës së punonjësit të policisë, vendos për lënien në fuqi të masës disiplinore të dhënë nga titullari ose ndryshimin e saj.”.

Neni 82

Pas pikës 9, të nenit 247, shtohet pika 9/1, me këtë përmbajtje:

“9/1. Kur punonjësi i policisë ndodhet me raport mjekësor, me pushime jashtë shtetit ose me pushime vjetore, komunikimi bëhet brenda 5 (pesë) ditëve pune nga dita e paraqitjes në detyrë të punonjësit.”.

Neni 83

Pika 3, e nenit 249, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Dokumentacioni që ka lidhje me ankimimet e masave të lehta, që shqyrtohen në Komisionet që ngrihen në përbërje të departamenteve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Komisionet Vendore të Apelimit, administrohen nga këto komisione dhe në përfundim të shqyrtimit, dërgohen në strukturën përgjegjëse për vlerësimin e performancës”.

Neni 84

Pika 1, e nenit 253, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Masa disiplinore shuhet pas kalimit të këtyre afateve:

- a) 6 muaj nga njohimi i masës “vërejtje” dhe “vërejtje me paralajmërim;”;
- b) një vit nga mbarimi i afatit për të cilin është zbatuar masa disiplinore “shtyrje e afatit të gradimit deri në 2 vjet” ose “Ulje në gradë për një periudhë deri në 6 muaj.”.

Neni 85

Kudo në këtë rregullore:

- a) emërtesa “Ministria e Punëve të Brendshme” zëvendësohet me fjalët “ministria përgjegjëse për çështjet e rendit dhe sigurisë publike”;
- b) emërtesa “Ministri i Punëve të Brendshme” zëvendësohet me fjalët “ministri përgjegjës për çështjet e rendit dhe sigurisë publike”;
- c) emërtesa “Drejtor i Policisë së Shtetit” zëvendësohet me “Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit”;
- ç) emërtesa “Zëvendësdrejtor i Policisë së Shtetit” zëvendësohet me “Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit”;
- d) fjalët “Drejtori e Përgjithshme” zëvendësohen me fjalën “Departament”;
- dh) emërtesa “Drejtoria e Policisë së Shtetit” zëvendësohet me “Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit”;
- e) emërtesa “drejtorët e përgjithshëm të policisë” zëvendësohen me “drejtorët e departamenteve të Policisë së Shtetit”;
- ë) emërtesa “Drejtoritë e Përgjithshme në Drejtorinë e Policisë së Shtetit” zëvendësohet me “Departamentet në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit”;
- f) emërtesa “Komision gradimi” zëvendësohet me “Komision vlerësimi”;
- g) emërtesa “shkolla bazë në Akademinë e Sigurisë” zëvendësohet me “Kolegji Profesional i Lartë “Kolegji i Policisë”;
- gj) emërtesa “Vendore/Rajonale” zëvendësohet me “Vendore”;
- h) emërtesa “specialistëve të policisë së zonave” zëvendësohet me “Ndihmësspecialistëve të Policimit në Komunitet/SPZ”;
- j) emërtesa “struktura për burimet njerëzore” zëvendësohet me “njësia e burimeve njerëzore”.

Neni 86

Lidhjet në këtë rregullore ndryshohen, si më poshtë vijon:

- 1. Lidhja nr. 1 hiqet.
 - 2. Në lidhjen nr. 2, fjalët “Modeli i regjistrit” hiqen.
 - 3. Në lidhjen nr. 5, fjalët “... në “Akademinë e Sigurisë ...” hiqen.
- II. Ngarkohet ministri i Brendshëm për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Lidhja nr. 18
Stema e Policisë së Shtetit

